



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:031341

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05855490

**2024:055183**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**, Departamenti I Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me pjesëmarrjen e sekretares juridike Indira Beqa ,në lëndën penale ndaj të pandehurit S.R nga Kaçaniku, i akuzuar për veprën penale, Prezantimi i rremë si person zyrtar nga neni 409 paragrafi 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj: PP.II.nr.1812/23 të dt.15 shkurt 2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 20 qershor 2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ibadete Hamiti dhe të pandehurit, me dt.25 qershor 2024 mori dhe shpalli, dhe të njejtën datë përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri S.R me vendbanim ne Kacanik , rruga "... ", i lindur më dt. ... ne te njëjtin vend, nga i ati N... dhe e ema Z..., e gjinisë A... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves , i martuar, prind i 2 femijeve , ka të kryer shkollën e fillore , i punësuar në fabrikën "...”në fsh....-Kaçanik, i gjendjes së dobët ekonomike , me nr.personal:....

### ËSHTË FAJTOR

Sepse gjatë muajit shtator të vitit 2023, në kohë të pacaktuar, në Kaçanik, i pandehuri me dashje dhe me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme për vete, e në dëm të dëmtuarit F. L., në atë mënyrë që me tu takuar me të dëmtuarin i ishte prezantuar rrejtshëm si person zyrtar - polic civil, ku të njëjtit i kishte premtuar rrejtshëm se do të i ndihmonte në lirim e parakohshëm të vëllait të të dëmtuarit i cili ishte në vuajtje të dënimit në burgun e Hajvalisë dhe në këmbim të kësaj i dëmtuari duhet të jap një shumë të parave, i dëmtuari i beson të pandehurit, ku fillimisht ia jep shumën prej 500 euro, më pas edhe 500 euro, pastaj 200 euro dhe përfundimisht 500 euro, dhe pas këtyre rrethanave i pandehuri përkundër kontaktimit përmes telefonit nga i dëmtuari për të ia kthyer paratë, fare nuk i përgjigjet dhe i shmanget kontaktit me të dëmtuarin ku edhe i dëmtuari aty kupton se kishte qenë i mashtruar duke iu prezantuar rrejtshëm si person zyrtar, me çka të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në shumën prej 1.600 euro.

Me këto veprime i pandehuri e ka kryer veprën penale, Prezantimi i rremë si person zyrtar nga neni 409 paragrafi 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,43,48,69,70 dhe 71 par.1 nenpar.1.3 të KPRK-së, si dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

## **GJYKON**

Me dënim me gjobë në shumë prej 450.00 € ( katërqind e pesëdhjetë euro), dhe me dënim me kusht, me të cilin i vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 12 muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në afat prej dy viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk do të kryejë vepër tjetër penale, në të kundërtën do t'i revokohet dënimi me kusht.

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t'a paguajë brenda afatit prej 30 ditësh, por jo me gjatë se dy muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe ate në 3 këste mujore.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do t'a zëvendesojë dënimin me gjobë, me dënim me burgim, duke llogaritur shumen prej 20 € për çdo ditë burgu.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 30,00 € , ndërsa në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit në shume prej 20.00€, të gjitha këto paguhen pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Konfor nenit 61 par.1 të KPRK-së, obligohet i pandehuri që të dëmtuarit F. L, t'i kompenzojë dëmin në vlerë prej 1600.00 €.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.II.nr.1812/23 të dt.15 shkurt 2024, të pandehurin S.R nga Kaçaniku, e ka akuzuar për veprën penale, Prezantimi i rremë si person zyrtar nga neni 409 paragrafi 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Në bazë të kësaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, me dt. 20 Qershor 2024.

Prokurorja e shtetit Ibadete Hamiti në fjalën e saj me rastin e prezentimit të aktakuzës , deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtuar me shkrim pranë kësaj gjykate.

I dëmtuari F. L. nuk ka qenë prezent në shqyrtimin gjyqësor.

I pandehuri në fjalën e tij në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se, e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza duke shprehur pendesë për veprimin e tij dhe duke i premtuar gjykatës se veprime të tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen., prandaj edhe shpreh gatishmërinë që t'a kompenzojë të dëmtuarin duke i kthyer paratë.

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj është dakorduar me pranimin e fajësise nga ana e të pandehurit, duke vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, duke kuptuar natyrën

dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 242 të KPP-së, andaj edhe I propozon gjykatës që të pranohet pranimi I fajësisë për të pandehurin dhe t'I shqiptohet sanksion penal sipas ligjit, duke e patur parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, ndërsa si rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit, motivin për kryerjen e veprës penale si dhe rrezikimin e të mirës së mbrojtur. Poashtu I propozon gjykatës që konfor nenit 61 të KPRK-së, të pandehurit t'I shqiptohet edhe dënimi plotësues, Urdhëri për kompensimin e humbjes apo dëmit të dëmtuarit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par. 1 të KPRK-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike, andaj me këto gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitivin e aktakuzës.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Prezantimi i rremë si person zyrtar nga neni 409 paragrafi 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në tërësi në shqyrtimin fillestar, duke shprehur pendesë dhe duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla dhe poashtu duke shprehur gatishmëri që t'a kompenzojë të dëmtuarin për dëmin e shkaktuar, ndërsa rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti faktin se i pandehuri në vitin 2018 ka patur edhe një rast penal të kësaj natyre, për të cilin është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë të dt.06.08.2021.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin S.R, i akuzuar për veprën penale, Prezantimi i rremë si person zyrtar nga neni 409 paragrafi 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi me të cilin i pandehuri urdhërohet për kompensimin e të dëmtuarit, u mor konform nenit 61 par.1 të KPRK-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**DEGA KAÇANIK**  
**2024:055183 datë 25.06.2024**

Sekretarja Juridike,  
Indira Beqa

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.